



Numër 04-2013
Datë 01.07.2013
Kontakti John J. Ryan

Komunikatë për shtyp – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka mbajtur seancën e 16-të në Prishtinë nga data 5 deri më 7 qershor 2013. Në fillim të seancës kanë qenë 18 ankesa në pritje pranë Panelit.

Paneli ka vendosur njëzëri se nga EULEX-i në Kosovë ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në [katër lëndë](#) që lidhen me incidentet në Vidovdan, 28 qershor 2012. Ankuesit kanë pohuar se ishin objekt i sulmeve, që përfshijnë, ndër të tjera, hedhjen e gurëve dhe koktejve të molotovit drejt fëmijëve adoleshentë, të cilët po udhëtonin me autobusë nga Gazimestani drejt Graçanicës pas përfundimit të festimeve të Vidovdanit. Paneli ka gjetur se EULEX-i kishte ndarë burime të pamjaftueshme për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut nga autoritetet e Kosovës dhe palëve të treta gjatë operacionit të sigurisë së Vidovdanit. Prandaj, ankuesit nuk kanë mundur t'i gëzojnë të drejtat e tyre sa i përket jetës private (të garantuara me nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) dhe nenin 17 të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), të drejtat e tyre për tubim (nenin 11 KEDNj; nenet 21 dhe 22 KNDCP) si dhe të drejtën e tyre për të ushtruar religjionin e tyre (nenin 9 KEDNj dhe nenin 18 KNDCP).

Për më tepër, Paneli ka gjetur se EULEX-i nuk ka arritur të kryej një hetim të plotë dhe të përshtatshëm rreth pohimeve për shkeljet e të drejtave të njeriut. Paneli rrjedhimisht ka konkluduar se ankuesve ju ishte mohuar mjeti juridik i përshtatshëm për shkeljet e të drejtave të tyre të njeriut dhe ka vendosur se ka pasur shkelje të të drejtës së tyre në mjetin juridik efektiv (neni 13 KEDNj; Neni 2 KNDCP). Paneli ka paraqitur një numër të rekomandimeve për masat korrigjuese në vendimet që u janë dërguar shefit të misionit të EULEX-it dhe ankuesve.

Paneli ka shpallur një [lëndë tjetër të pranueshëm](#) në lidhje me kryerjen e supozuar të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ana e një anëtari ndërkombëtar të personelit të EULEX-it ndaj një zyrtareje të policisë së Kosovës. Paneli ka ftuar shefin e misionit të EULEX-it dhe ankuesen të paraqesin vërejtjet e tyre shtesë mbi meritat e kësaj lënde. Një [lëndë tjetër është gjetur si i papranueshëm](#). Ajo ka të bëjë me një kontest pune ndërmjet ankuesit dhe ish punëdhënësit të tij, Korporatës Energjetike të Kosovës. Gjatë seancës, Paneli i ka dërguar dy lëndë të tjera tek shefi i misionit për informata dhe komente.

Ndërtesa e PSHDNj-së
Rr. Rustem Statovci; nr. 29
10000 Prishtinë
Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125, Fax: +381 (0) 38 78 7711
office@hrp.eu www.hrp.eu

Të gjitha vendimet do të publikohen në faqen e internetit të Panelit pasi të përkthehen në gjuhën shqipe dhe serbe.

Seanca e ardhshëm e Panelit është planifikuar të mbahet nga 27 deri më 30 gusht 2013, në Prishtinë. Për momentin janë 27 lëndë të papërfunduara, gjashtë prej tyre u janë dërguar palëve, dy janë shpallur të pranueshme dhe 19 janë në pritje për tu shqyrtuar.

Për më shumë informata rreth Panelit, ju lutemi vizitoni www.hrrp.eu.

Shënim për redaktorin,

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) për EULEX-in në Kosovë, si mekanizëm i pavarur llogaridhënës për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut, shqyrton ankesat e çdo personi që deklaron se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë përmbushjes së mandatit ekzekutiv të tij. Paneli nuk është trup gjyqësor ose disiplinor. Ky mekanizëm merret vetëm me konstatimin nëse ka pasur shkelje apo nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe formulon rekomandime për veprime korrigjuese. Veprimi i tillë nuk përfshinë kompensimin me të holla. Paneli është i pavarur gjatë kryerjes së funksioneve të tij, të cilat i kryen me paanësi dhe integritet.